

## STILI

# Struktura dhe Gjatsia e Fjalive

Analiza e sintaksës hulumton të gjitha mostrat e fjalive.

*Llojet e fjalive:* a) nëse teksti dominohet prej fjalish të thjeshta, të përbame, komplekse, apo të përbame-komplekse, b) nëse fjalitë janë kryesisht të gjata, të mesëme, apo të shkurta, c) nëse dominon përdorimi i lidhjes parataktike, ku fjalitë vendosen pranë njënjtetrës pa lidhëza, ose hypotaktike ku lidhëzat vendosen qartsisht në mes të njësisive në mënyrë që me tregua lidhjet logjike në mes tyre, ç) nëse shumica e fjalive janë deklarative, çuditëse, pyetëse, ose nxitëse apo komanduese. (Shih Sintaksën)

*Preferenca e klauzave:* Çfarë klauzash preferon autori: a) klauza të nënrendituna emëneore, mbiemënore (relative), a ndajfoljore, b) klauza skajore (en. finite) apo klauza që nisin me joskajore (en. non-finite)

*Kobezioni i fjalive:* Brenda paragrafëve, si lidhen fjalitë: a) nëpërmjet shoqimit me njënjtetrën (en. associative connection), b) nëpërmjet lidhëzave që tregojnë unitet logjik, apo c) në qoftë se fjalitë përsëriten, çfarë strukturash kanë pjesët e përsërituna?, etj.

Në fjalí përfshihen mostrat theksore, ritmi i gjatsisë së zanoreve, ritmi i rrokjeve të theksuome e të patheksuome, si edhe paralelizmi, përsëritja, dhe antiteza e fjalëve, frazave, dhe klauzave. Detyra e stilitit është me pasqyrua jo vetëm ritmin artistik e kadencën (ritmin lemor të gjuhës), por më s'forti ritmin e jetës. Imagjino sikur të shkruash rreth *ritmit të zemrës, gurgullimit të ujit, zhurmës së qytetit, qetsisë së katundit, ose madhështisë së Alpeve*. Suksesi më i madh i këtyne shkrimeve do të ishte jo mjeshtria e stilit por përcimi i ritmit të jetës.

Fjalitë përdoren në poezi, dramë, e prozë. Në prozë, fjalitë zgjanohen në trí mënyra, a) *nëpërmjet kallzuesve*, b) *nëpërmjet klauzave të nënrendituna*, dhe c) *nëpërmjet modifikuesve*

Ndërsa nënrenditja është më logjike, arritja e cakut s'është më e hapun, më artistike, dhe arrihet më mirë nëpërmjet modifikuesve të lirë sesa klauzave të nënrendituna dhe klauzave kushtore. Por, duhet cekë që ritmi i fjalisë peshon si në nxitjen me lexua fjalinë, si në kuptimin e fjalisë.

Kuptimi lidhet edhe me artin e ritmit dhe me kadencën (ritmin natyror të një gjuhe), prandaj, një autor i vërtetë duhet me pasë edhe vesh poetik.

*Fjalía* i jep mendimit formën, *aserta* kuptimin, ndërsa *retorika* peshën. Prandaj, fjalía duhet me qenë jo vetëm gramatikisht e korrekte, jo vetëm logjikisht e vlerhtë, por edhe me peshua mbë një audiencë të caktuome. *Gramatika* reflekton marrdhanjen në mes fjalëve, *logjika* marrdhanjen e evidencës me arsyen, ndërsa *retorika* marrdhanjen në mes të autorit

dhe audiencës. Gramatisti pyet si *funksionojnë* fjalët në një fjalí, logjicisti<sup>1</sup> si *ndërtohet* mendimi, ndërsa retoristi pyet, cili është *motivi* i autorit dhe cila është *pesha* ligjratës mbë audiencën.

Për ata që pasojnë Heminguejn, me fjalën ‘stil’ kuptohet shkrimi i fjalive të shkurta, të qarta, e direkte; ngjashëm me një shkenctar që që përshkruan një gurë të rrallë. Por, thjeshtsia nuk është thjeshtim; ajo është e kundërta e ndërlikjeve të panevojta. Thjeshtsia nuk përjashton as stilin as fjalitë e gjata e të ndërlikta; kur këto të fundit ndërtohen mjeshtrisht.

Kurse për ata që pasojnë Faulknerin, fjalia duhet me depërtua aty ku shqisat verbohen.

Fjalia feskon<sup>2</sup> jo vetëm stilin por edhe kompetencën gjuhsore e logjike të autorit.

Vërej ndërrimin e rendit të fjalëve në fjalitë pasuese:

1. **Statuja e Gjelinës** duhet të ngrihet në mes të Shkodrës.
2. **Në mes të Shkodrës** duhet të ngrihet statuja e Gjelinës.
3. **Duhet të ngrihet statuja e Gjelinës** në mes të Shkodrës.

Këtu fjalët janë të njëjta, por ndërrimi i renditjes së tyre i ndërron kuptimin fjalisë. Tipikisht, fjalët në nisje të fjalisë peshojnë më randë se fjalët pas tyre.

---

<sup>1</sup> Krahaso logjicist vs. logjikist me elektrikist vs. elektrikist

<sup>2</sup> fesku, me – me zditë, me i fokusua dritën një pjese të tansisë